



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3234/2025**

A.nr.557/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj, si procesmbajtës, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.557/2025, të datës 26.03.2025, të parashtruar nga ankuesja S. R-Sh, kundër njoftimit të datës 12.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa A.nr.557/2025, e datës 26.03.2025, e parashtruar nga ankuesja, S. R-Sh.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, S. R-Sh, (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 26.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 12.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN000165522, për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa, të shpallur nga MBPZHR.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesja është e parakohshme, *sepse*:

Nga analizimi i provave të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 28.01.2025, ka shpallur konkursin publik me numër të referencës RN00016522, për grupin Buxhet dhe Financa, respektivisht për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa, klasa profesional 2, për një 1 pozitë.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, mirëpo të njëjtës përmes Njoftimit të datës 12.03.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të

Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se e njëjta nuk ka përmbushur kriteret e përcaktuara të konkursit, ngase ankuesja nuk ka bashkangjitur dëshminë nëpërmjet të cilës vërtetohet fakti se ka provojë pune se paku një (1) vite të mbështetur me pasqyrën e fondit të kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së e njëjta me rastin e aplikimit ka përmbushur gjitha kushtet duke e bashkangjitur kontratën e punës që janë dëshmi për punën dhe kontributet financiare për vitin e fundit, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për të vazhduar me këtë procedurë të rekrutimit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative, si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit Në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: 17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në provat e administruara Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja me datë 26.03.2025, kundër Njoftimit të datës 12.03.2025, lidhur me refuzimin e aplikacionit për procedurën kontestuese, është e parakohshme, ngase sipas përgjigjes në ankesë të datës 15.04.2025 nga organi i punësimit e sqaron se kjo procedure e rekrutimit nuk kishte përfunduar me datën 26.03.2025 në momentin kur ankuesja ka parashtruar ankese në Këshill, dhe sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati për praninë në shërbim civil ka të drejtë të parashtrojë ankese vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesja ka parashtruar ankese ende pa përfunduar procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit publik me numër të referencës RN00016522 të datës 28.01.2025.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesja me datë 26.03.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.557/2025, të datës 26.03.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë e ankesës me numër A.nr.557/2025, nuk e mohon të drejtën e ankueses, që të kundërshtojë ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.557/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, S. R-Sh,
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.